

VENDIM
Nr. 807, datë 26.11.2014

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.747, DATË 5.11.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT ME SHKËMBIM
LETRASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUAJTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.747, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohen paragrafët i dytë dhe i tretë, me këtë përmbajtje:

“Autorizohet ministri i Financave për të nënshkruar kontratën e përdorimit të grantit.

Lëvrimi i grantit të bëhet në një llogari speciale në Bankën Qendrore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama